REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI

Nr. 1604/2 Prot. Tiranë, më 06 . 10 .2026

V E N D I M

Nr. 273 , Datë 06 . 10 . 2026

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 215, datë 01.09.2026[1], e paraqitur nga znj. V.Gj, e përfaqësuar[2] nga Avokat N.P dhe K.R kundër Bashkisë Shkodër, Policisë Bashkiake të Bashkisë Shkodër dhe Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Shkodër me pretendimin për diskriminimin për shkak të *"gjendjes shëndetësore", "aftësisë së kufizuar[3]"* dhe *"moshës[4]"*.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi[5],

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe dokumentacionit të dërguar me email-in datë 05.09.2026, përfaqësuesi i subjektit ankues, në mes të tjerash informon se: *"Shtetasja V.Gj, është grua e moshuar dhe është person me aftësi të kufizuar. Për shkak të gjendjes shëndetësore lëviz vetëm me karrocë dhe është plotësisht e varur nga ekzistenca e një kalimi të sigurt dhe të përshtatshëm për hyrjen dhe daljen nga banesa. Hyrja dhe dalja nga banesa realizohen nëpërmjet një rrugice që lidhet me rrugën publike. Kjo rrugicë përbën kalimin e vetëm funksional dhe të përdorshëm për të hyrë dhe dalë nga prona.*

Shtetasi M.K ka vendosur dhera, inerte dhe materiale ndërtimore në këtë rrugicë dhe ka kryer punime që e kanë bërë të pamundur kalimin me karrocë. Si rezultat, është izoluar faktikisht në banesën dhe pronën e saj. Nuk mund të dalë në mënyrë të pavarur për të marrë shërbime shëndetësore, barna, ushqime dhe shërbime të tjera të domosdoshme. Bllokimi pengon edhe hyrjen e ambulancës, zjarrfikëses dhe mjeteve të tjera të emergjencës.

[1] Ankesa është plotësuar me informacionin e dërguar nga përfaqësuesi i ankueses me email-in datë 05.09.2026.
[2] Referuar Prokurës së Posaçme nr. repertori 4065, nr. koleksioni 2904, date 26.08.2026.
[3] Ankuesja nuk ka dërguar dokumentacion për të provuar aftësinë e kufizuar.
[4] Ankuesja është 77 vjeçe.
[5] Në vijim do t'i referohemi me akronimin: KMD.

Për shkak të lëvizjes vetëm me karrocë, pengesat e vendosura i kanë hequr plotësisht mundësinë e hyrjes dhe daljes, duke e vendosur në një gjendje izolimi, varësie dhe rreziku të vazhdueshëm.

Për ngjarjen ka paraqitur kallëzim pranë Komisariatit të Policisë Shkodër më datë 24.08.2026. Gjithashtu ka vënë në dijeni Bashkinë Shkodër, Policinë Bashkiake dhe Inspektoratin Vendor të Mbrojtjes së Territorit (datë 26.08.2026).

Pavarësisht natyrës së rëndë dhe urgjente të rastit, kalimi nuk është liruar dhe nuk i është garantuar një zgjidhje e përkohshme që të mundësojë lëvizjen me karrocë. Vijimi i kësaj gjendjeje e ekspozon ndaj një trajtimi të pabarabartë dhe cenon dinjitetin, sigurinë, autonominë dhe të drejtën për jetesë të pavarur.

Organet publike, pasi marrin dijeni për aftësinë e kufizuar dhe rrezikun konkret, kanë detyrimin të shqyrtojnë nevojat e saj individuale dhe të marrin masa efektive dhe të përshtatshme për garantimin e aksesit. Mungesa e një ndërhyrjeje të përshtatshme, qoftë edhe të përkohshme, për hapjen e një korridori të sigurt për karrocën, përbën mosgarantim të aksesueshmërisë. Ajo e privon nga ushtrimi, në kushte të barabarta me të tjerët, i të drejtës së lëvizjes, pronësisë, shërbimit shëndetësor dhe jetesës së pavarur".

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të rekomandojë ose urdhërojë, sipas kompetencave ligjore, marrjen e masave të menjëhershme për hapjen e një korridori të sigurt, me gjerësi dhe sipërfaqe të përshtatshme për lëvizjen me karrocë dhe për hyrjen e shërbimeve të emergjencës dhe që çdo veprim i mëtejshëm në atë sipërfaqe të kryhet vetëm pas verifikimit të plotë nga organet kompetente.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se shpjegimet dhe dokumentacioni i dërguar nga ankuesi ishin të paqarta lidhur me veprimet/mosveprimet e subjekteve kundër të cilëve drejtohej ankesa dhe lidhjes shkakësore ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur.

Për këtë arsye, me email-in, datë 04.09.2026, Komisioneri ka kërkuar nga përfaqësuesi i subjektit ankues, dokumentacion për të provuar aftësinë e kufizuar të ankueses dhe si kanë qenë në dijeni subjektet kundër të cilëve drejtohet ankesa. Kopje të ankesave/kërkesave drejtuar Bashkisë Shkodër, Policisë Bashkiake të Bashkisë Shkodër dhe IMT të Bashkisë Shkodër dhe kopje të përgjigjeve të marra dhe kopje të kallëzimit të datës 24.08.2026.

Subjekti ankues me email-in datë 05.09.2026, dërgoi vetëm kopje të kërkesave drejtuar institucioneve.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi",* të ndryshuar, përcaktohet se: *"Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore,*

gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër".

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi",* i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *"Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi".*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi",* të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Nga interpretimi i dispozitave të sipërcituara rezulton se diskriminimi nuk identifikohet vetëm nga ekzistenca e një veprimi ose mosveprimi të pretenduar si të paligjshëm, të padrejtë, neglizhent ose të papërshtatshëm. Për ngritjen e një pretendimi të pranueshëm për diskriminim duhet të ekzistojnë, të paktën në nivel paraprak, tre elemente të ndërlidhura: - një trajtim i pafavorshëm, dallim, kufizim, përjashtim apo mosveprim; - një shkak i mbrojtur nga ligji; - një lidhje shkakësore ndërmjet trajtimit të pafavorshëm dhe shkakut të mbrojtur.

Shkaku i diskriminimit nuk mund të jetë vetëm një karakteristikë personale që personi e posedon. Duhet të ekzistojnë fakte, rrethana ose indicie nga të cilat të mund të prezumohet se pikërisht kjo karakteristikë ka motivuar, ndikuar ose ka qenë baza e trajtimit të kundërshtuar.

Në rastin konkret, ankuesja referuar moshës, i përket kategorisë së personave të moshuar dhe referuar fotove të dërguara përdor karrocë me rrota. Nga shqyrtimi i ankesës dhe i dokumentacionit të paraqitur, Komisioneri konstaton se nuk rezulton ndonjë fakt, deklaratë, dokument, veprim, kriter apo rrethanë konkrete nga e cila të mund të prezumohet se Bashkia Shkodër, Policia Bashkiake e Bashkisë Shkodër dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Shkodër kanë refuzuar ose kufizuar veprimet e tyre për shkak të gjendjes shëndetësore apo të moshës së saj. Pretendimet e ankueses përqendrohen në faktin se institucionet nuk kanë reaguar në mënyrën, intensitetin ose afatin që ajo konsideron të nevojshëm ndaj kërkesave të saj.

Këto pretendime mund të ngrenë çështje lidhur me mënyrën e ushtrimit të kompetencave ligjore nga Bashkia Shkodër, strukturat e mbrojtjes së territorit ose organe të tjera administrative, por në mungesë të një lidhjeje me një shkak të mbrojtur, ato nuk përbëjnë automatikisht çështje diskriminimi.

Ankesa lidhet me mënyrën konkrete të trajtimit të një konflikti pronësor dhe ndërtimor dhe me veprimet ose mosveprimet institucionale në një rast individual. Po kështu, ankuesja i referohet pozitës së saj si "e moshuar" dhe përdorimit të karrocës dhe pretendon një efekt të kombinuar të karakteristikave të saj. Në rastin konkret nuk rezulton ndonjë fakt nga i cili të mund të

konkludohet, qoftë edhe paraprakisht, se kombinimi i gjendjes shëndetësore dhe moshës së ankueses ka ndikuar në mënyrën se si institucionet kanë trajtuar kërkesat e saj.

Ankuesja e ndërton në pjesën më të madhe pretendimin e saj mbi bindjen se institucionet kanë favorizuar një palë tjetër të konfliktit dhe kanë neglizhuar kërkesën e saj. Por favorizimi i pretenduar i një pale tjetër nuk është, në vetvete, diskriminim sipas ligjit nr. 10221/2010, të ndryshuar, nëse nuk tregohet se diferenca në trajtim ka ardhur për shkak të një karakteristike të mbrojtur të ankueses ose të personit krahasues.

Pretendimi se ankuesja është e moshuar dhe përdoruese e karrocës nuk identifikon në vetvete, një shkak diskriminimi. Gjendja shëndetësore dhe përdorimi i karrocës është një status social që mund të lidhet në rrethana të caktuara me moshën, por për t'u ngritur një pretendim për diskriminim duhet të tregohet se pikërisht kjo karakteristikë ka qenë arsyeja e trajtimit të pafavorshëm. Për më tepër, lidhur me situatën, përfaqësuesit e ankueses i kanë dërguar shkresë/kërkesë Bashkisë Shkodër dhe IMT të Bashkisë Shkodër në datë 26.08.2026 dhe po në të njëjtën datë kanë bërë ankim dhe pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke mosprovuar faktin se si kanë qenë në dijeni institucionet për moshën dhe gjendjen shëndetësore të subjektit ankues.

Komisioneri vlerëson se çështjet e parashtruara nga ankuesja lidhen me përdorimin e pronës, zbatimin e legjislacionit në fushën e territorit dhe mënyrën e ushtrimit të kompetencave nga institucionet përgjegjëse. Megjithatë, vlerësimi i ligjshmërisë së veprimeve ose mosveprimeve të Bashkisë Shkodër, Policisë Bashkiake të Bashkisë Shkodër dhe Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Shkodër, në vetvete, nuk përbën objektin e këtij shqyrtimi. Objekti i shqyrtimit të Komisionerit kufizohet në vlerësimin nëse veprimet ose mosveprimet e këtyre institucioneve kanë sjellë një trajtim të ndryshëm ose një disavantazh të veçantë të lidhur me ndonjë prej shkaqeve të mbrojtura nga ligji nr. 10221/2010, *"Për mbrojtjen nga diskriminimi"*, të ndryshuar.

Pretendimet lidhur me verifikimin në terren të statusit juridik të sipërfaqes të përdorur si rrugë kalimi, bllokimit të kalimit, lejes së ndërtimit apo të identifikimit të personit që ka vendosur materialet (dherat, inertet) janë çështje që lidhen me zbatimin e legjislacionit, administrativ, urbanistik dhe penal dhe kanë mekanizmat e tyre përkatës të kontrollit administrativ dhe gjyqësor.

Vetë dokumentacioni i paraqitur nga ankuesja tregon se ajo ka përdorur edhe mekanizma të tjerë ligjorë, përfshirë kallëzimin e bërë pranë Komisariatit të Policisë Shkodër.

Ekzistenca e këtyre procedurave nuk përjashton në vetvete kompetencën e KMD-së, por demonstron se mosmarrëveshja e ngritur ka në thelb çështje të ligjshmërisë së veprimeve dhe mosveprimeve të institucioneve.

Në mungesë të indicieve se këto veprime apo mosveprime janë bërë për shkak të gjendjes shëndetësore dhe moshës ose një shkaku tjetër të mbrojtur, ato nuk marrin karakter diskriminues vetëm për faktin se ankuesja i percepton si të padrejta, të qëllimshme ose favorizuese ndaj palës tjetër.

Nuk rezulton ndonjë koment apo qëndrim diskriminues nga punonjësit e institucioneve në lidhje me moshën ose gjendjen shëntetësore të ankueses; nuk rezulton përdorimi i një kriteri të lidhur me këto karakteristika; nuk paraqitet një praktikë e përgjithshme që prek në mënyrë disproporcionale kategoritë të cilave ankuesja pretendon se u përket; nuk rezulton trajtim krahasues që të sugjerojë se persona në situatë të ngjashme, por pa këto karakteristika, janë trajtuar ndryshe; dhe nuk ka ndonjë element tjetër objektiv nga i cili të mund të deduktohet motivimi diskriminues.

Pala ankuese ka identifikuar një seri veprimesh ose mosveprimesh që ajo i konsideron të padrejta dhe potencialisht të kundërligjshme, por nuk ka sjellë fakte apo indicie të mjaftueshme që t'i lidhin ato me moshën dhe gjendjen shëndetësore. Për rrjedhojë, shkaku i diskriminimit, në kuptimin juridik dhe funksional të ligjit, nuk rezulton i evidentuar në raport me trajtimin e kundërshtuar.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, shkronja "ç[6]", të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga subjekti ankues, nuk mund të pranohet, pasi është haptazi e pabazuar dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj[7].

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 32 dhe 33, pika 4, germa "ç", të ligjit 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi",* të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 215, datë 01.09.2026, paraqitur nga znj. V.Gj, për arsye se nuk përmbushen kushtet ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga ligji 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi",* i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)

[6] *"Ankesa nuk pranohet nëse: ...ç) është haptazi e pabazuar ose ..... ".*

[7] Për analogji citojmë vendimet: nr. 126, datë 21.05.2025, nr. 171, datë 17.06.2026 dhe nr. 233, datë 19.08.2026 të KMD-së.